



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI' VLORE
REKTORATI

Nr. 1859/1 Prot.

Vlorë, më, 11.11.2020

VENDIM

Nr.20 datë 06. 11. 2020

PËR

“MIRATIMIN E PROPOZIMIT TË ADMINISTRATORES PËR NDRYSHIME TË AFATEVE DHE MËNYRËS SË PAGESËS SË TARIFËS SË SHKOLLIMIT”

Në zbatim të ligjit 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” Neni 52 “Funksionet e Administratorit”, Statutit të Universitetit, Udhëzimit Nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e Aktiveve në njësite e Sektorit Publik”, Vendimeve të Senatit Akademik Nr.30, datë 27.06.2018 si dhe Vendimit Nr.55, datë 06.09.2018, Vendimeve Nr.13, datë 16.07.2018 të Bordit të Administrimit për ciklin e I-rë të studimeve si dhe Vendimit nr.22, datë 18.09.2020, në mbledhjen e zhvilluar online në datën 06.11.2020, Rektorati

VENDOSI

Miratimin e ndryshimeve të afateve dhe mënyrës së pagesës së tarifës së shkollimit

Për ciklin e I-rë të studimeve:

1. Tarifa vjetore e shkollimit për një program të parë të ciklit të parë të kryhet Brenda 60 ditëve nga dita e fillimit të vitit akademik.
2. Tarifa vjetore e shkollimit për një program të dytë të ciklit të parë të kryhet me dy këste të barabarta ku:
 - Kësti i parë të paguhet brenda 60 ditëve nga data e fillimit të vitit akademik.
 - Kësti i dytë të paguhet brenda 30 ditëve nga fillimi I semestrit të dytë.
3. Për ata studentë të cilët ndjekin një program të dytë studimi në ciklin e parë të studimeve dhe që plotësojnë kriteret për përjashtim tarife sipas VKM-së, por kriteri përjashtues i tyre është program i dytë i studimit, pagesa do të bëhet me këste të barabarta gjatë gjithë vitit akademik.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI' VLORË
REKTORATI

Për ciklin e dytë të studimeve:

1. Për ata studentë të cilët ndjekin një program të parë dhe të dytë studimi në ciklin e dytë të studimeve, pagesa do të bëhet me 4(katër) këste të barabarta gjatë gjithë vitit akademik.
 - Kësti i I-rë do të bëhet brenda 30 ditëve nga fillimi I vitit akademik.
 - Kësti i II-të do të bëhet përpara sezonit të semestrit të I-rë.
 - Kësti i III-të do të bëhet përpara sezonit të semestrit të dytë.
 - Kësti i IV-ërt do të bëhet përpara diplomimit(për vitin e dytë) dhe Brenda muajit shtator për vitin e I-rë.
2. Për ata studenët të cilët ndjekin një program të dytë studimi, në ciklin e dytë të studimeve dhe që janë studentë ekselentë, por nuk e përfitojnë reduktimin e tarifës sipas VKM-së, për kriterin përjashtues se, është program i dytë studimi, pagesa do të bëhet me këste të barabarta gjatë gjithë vitit akademik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

REKTORI

Prof. Dr. Roland ZISI

